



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/03/2022

VENDIM
Nr.06, date 30 /03/2022

PËR

**PROBLEMATIKAT NE LIDHJE ME PUNIMET E NDERTIMIT NE DIGEN E
XHAHZOTAJ QE SHFRYTEZOHET NGA BASHKIA DURRES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.03.2022 mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Durrës në lidhje me evidentimin e disa punimeve të ndërtimit që po kryhen në trupin e digës pa lejen e kësaj Bashkie. Bazuar në informacionet dhe dokumentacionin e KKDM, rezulton se deri me sot për këto punime nuk ka asnjë kërkesë për aprovim të projektit të zbatimit dhe asnjë shqyrtim apo miratim projekti nga ana e KKDM.

Bazuar në Legjislacionin e mësipërm, shfrytëzuesi i digës dhe ujëmbledhësit të Xhafzotaj (Bashkia Durrës) është përgjegjës kryesor për sigurinë e digës dhe nënobjekteve të tjera që lidhen me të si dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë. Tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare që merr shfrytëzuesi duhet të garantojnë shfrytëzimin normal të objektit, jetëgjatësinë e tij dhe mosçënimin e faktoreve që ndodhen në pjesën e poshtme të digës.

Antarët e pranishëm të KKDM diskutuan në lidhje me këtë kërkesë duke u bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur, në legjislacionin e mësipërm si dhe në faktin që KKDM nuk ka shqyrtuar deri me sot asnjë projekt zbatim për këto punime ndërtimi. Pas diskutimeve të të gjithë antareve të pranishëm, KKDM,

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Bashkisë Durrës si shfrytëzuese e digës së Xhafzotaj

- Pezullimin e menjëhershëm të punimeve të ndërtimit që kanë filluar në trupin e digës së Xhafzotaj.
- Marrjen e masave të menjëhershme teknike dhe ligjore për zgjidhjen e problematikave të konstatuara për të garantuar shfrytëzimin normal të objektit dhe sigurinë e digës në të ardhmen
- Përgatitjen e Planeve të Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile duke përfshirë edhe kurbat e volumeve të ujit në ujëmbledhësin si dhe hartat e përmbajtjeve për zonen poshtë digës së Xhafzotaj.
- Informimin e KKDM në lidhje me masat e marra dhe zgjidhjen e problematikave të mësipërme brenda muajit Maj 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

